



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 89 Prot.

Tiranë, më 26 shkurt 2019

V E N D I M

Nr. 4, datë 26 shkurt 2019

“Për aprovimin e dokumentit “Mbi vazhdimin e reformës në akademinë e Shkencave, kodin e etikës dhe për shkencën në përgjithësi” dhe amendimin e Statutit të Akademisë së Shkencave”

Drejtuar: Seksioneve Shkencore të Ash-së.

Për dijeni: Z. Engjëll Agaçi
Sekretar i Përgjithshëm
Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë, Tiranë

Në zbatim të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 « Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë », i ndryshuar, të Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbështetje të rendit të ditës (*shkresa nr. prot. 79, datë 19.02.2019, bashkëmbyllur*), të propozuar nga Kryesia dhe Këshilli Ekzekutiv dhe të aprovuar nga Asambleja në mbledhjen e saj të datës 26 shkurt 2019, pas arritjes së kuorumit asambleja;

V e n d o s i:

1. Të aprovojë dokumentin “Mbi vazhdimin e reformës në akademinë e Shkencave, kodin e etikës dhe për shkencën në përgjithësi”, sipas tekstit bashkëmbyllur këtij vendimi.
2. Të miratojë amendimin në nenin 14 të Statutit të ASH-së, si më poshtë: *Të drejtën e votës vendimore e kanë edhe anëtarët e Asamblesë mbi 75 vjeç, kur marrin pjesë në mbledhje. Mospjesëmarrja në mbledhje nuk ndikon në llogaritjen e kuorumit.* Ky ndryshim në zbatim të vendimit nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese, urdhëruar me vendim datë 30 janar 2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:
Të miratojë amendimin në nenin 17 të Statutit të ASH-së, si më poshtë: *Mandati i anëtarit të Kryesisë dhe Këshillit Ekzekutiv vazhdon deri në zgjedhjen e të riut, në çdo rast, për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj.*

3. Të caktojë 24 majin 2019 si ditën e zgjedhjeve të reja për Kryesinë dhe Këshillin Ekzekutiv (për postet që kanë përfunduar mandatin), konform detyrimit ligjor për kryerjen e zgjedhjeve të rradhës brenda kufirit maksimal të parashikuar në ligj dhe statut. Komisioni i zgjedhjeve i ngritur me vendimin nr. 1, datë 10 janar 2019, të shpallë 45 ditë para kësaj date kriteret dhe procedurat e zhvillimit të këtyre zgjedhjeve.
4. Amendimet e Statutit hyjnë në fuqi menjëherë dhe këto ndryshime të reflektohen në dokumentin e STATUTIT të publikuar në web dhe në të gjitha kopjet e tij që përdoren nga ASH-ja.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR SHKENCOR

VASIL S. TOLE

